

VENDIM
Nr. 16, datë 12.3.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 12.3.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 14 (E) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: ELISABETA CARA, përfaqësuar nga avokatët Rudin Birçaj dhe Erlis Nakollari.

SUBJEKT I INTERESUAR: Posta Shqiptare sh.a., Filiali Fier, përfaqësuar nga Suela Prifti, drejtore filiali.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-3578, datë 7.12.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuases Elisabeta Cara, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Postës Shqiptare sh.a., Filiali Fier (*Posta Shqiptare*) që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, mendimin me shkrim të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuessa Elisabeta Cara ka qenë në marrëdhënie pune pranë Postës Shqiptare, me detyrë shpërndarëse e postës, për periudhën 3.3.2008–13.3.2014. Me vendimin nr. 18, datë 13.3.2014, asaj i është dhënë masa disiplinore e largimit nga detyra, për shkak të konstatimit të mangësive në punë. Kërkuessa, duke pretenduar se kontrata e punës është zgjidhur në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padi për dhënien e dëmshpërblimeve respektive, sipas përcaktimeve në Kodin e Punës.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2015-59 (24), datë 14.1.2015, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se kontrata ishte zgjidhur në mënyrë të menjëhershme dhe për shkakë të justifikuara në përputhje me nenet 153 dhe 154 të Kodit të Punës.

3. Mbi ankimin e kërkuësës, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 921, datë 14.7.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të njëjtin arsyetim. Ajo ka vlerësuar se nga kërkuësja nuk janë zbatuar detyrat në zonën që ajo ka kryer shërbimin e postierit dhe, për rrjedhojë, masa disiplinore e largimit nga puna ka qenë e bazuar. Kundër këtij vendimi kërkuësja ka paraqitur rekurs.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-3578, datë 7.12.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Sipas Gjykatës së Lartë, gjykatat më të ulëta e kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejtë atë dhe vendimet e dhëna prej tyre nuk janë në kundërshtim me ndonjë vendim të kësaj gjykate, ndërsa pjesa e pretendimeve që ngre çështje të vlerësimit të provave, del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të saj.

5. Në vijim, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesën, sipas objektit, e cila është regjistruar në këtë Gjykatë më datë 30.6.2023.

6. Kolegji i Gjykatës, i mbledhur më datë 5.10.2023, ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, ndërsa kjo e fundit, me vendimin e datës 11.10.2023, bazuar në nenin 31, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kthimin e kërkesës për plotësim aktesh kërkuësës me qëllim paraqitjen e argumenteve dhe provave lidhur me respektimin e afatit ligjor 4-mujor të paraqitjes së ankimit kushtetues individual. Më datë 26.10.2023 kërkuësja ka paraqitur argumentet për datën e marrjes dijeni të vendimit të kundërshtuar. Në vijim, Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 6.11.2023, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

7. Me vendimin nr. 505, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KL Gj) “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, Gjykata e Apelit Vlorë ka ndërprerë veprimtarinë më datë 31.1.2023 dhe funksionet e saj ushtrohen nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me seli në Tiranë. Ndërsa me vendimin nr. 131, datë 28.3.2023 të KL Gj-së “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”, kjo gjykatë prej datës 1.5.2023 ka zëvendësuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Në këto rrethana, në tekstin e këtij vendimi, këto institucione janë referuar me emrat përkatës gjatë kohës së lëshimit të vendimeve gjyqësore të tyre.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. Kërkuësja, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se Gjykata e Lartë i ka cenuar:

8.1 *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.1.1 *Parimit të kontradiktoritetit, së drejtës për t'u mbrojtur dhe dëgjuar*, pasi nuk i është dhënë mundësia të argumentojë shkaqet e rekursit. Gjykata e Lartë nuk ka analizuar nëse kanë ekzistuar ose jo shkaqet e justifikuara për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Njoftimet e kryera nga punëdhënësi janë absolutisht të pavlefshme dhe bien ndesh me nenin 37 të Kodit të Punës, pasi nuk i është garantuar e drejta për t'u dëgjuar, mbrojtur dhe për të parashtruar fakte dhe prova brenda një afati të arsyeshëm. Punëdhënësi nuk ka argumentuar se cilën pikë të rregullores së punës ka shkelur kërkuësja dhe masat disiplinore nuk janë regjistruar në regjistrin e punonjësit. Ai nuk ka respektuar as afatin ligjor 3- mujor të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës. Gjykata e Lartë ka vepruar ndryshe nga qëndrimi i saj

i mëparshëm, sikurse në vendimet nr. 00-2022-2325 (334), datë 28.9.2022 dhe nr. 00-2023-1131 (99), datë 1.3.2023.

8.1.2 *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë jo vetëm duhej ta kishte kaluar çështjen për shqyrtim në seancë plenare me praninë e palëve, por duhej të niste edhe njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore. Qëndrimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar kërkuueses pritshmëritë për ndryshimin e një situate të pafavorshme ligjore ndaj saj.

8.1.3 *Parimit të ligjshmërisë*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka analizuar veprimet e punëdhënësit për vendosjen e masave disiplinore ose afateve dhe shkaqeve në zgjidhjen e kontratës së punës, duke iu referuar kërkesave të neneve 37 dhe 143 të Kodit të Punës.

8.2 *Parimin e mosdiskriminimit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi nëse Gjykata e Lartë do ta kishte shqyrtuar çështjen në seancë me praninë e palëve, do të kishte konstatuar se shkaqet e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës lidhen me arsye fetare dhe politike. Kërkuësja është praktikante e fesë myslimane, e persekutuar politike gjatë regjimit komunist dhe e orientuar me ide politike të djathta.

9. Subjekti i interesuar, Posta Shqiptare, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

9.1 Pretendimi i kërkuueses për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* është i pabazuar, pasi në rastin e saj janë respektuar afatet ligjore në procedurën e ndjekur dhe zgjidhja e marrëdhënieve të punës ka qenë e justifikuar, për shkak të shkeljeve disiplinore të përsëritura dhe qëndrimit jo korrekt të kërkuueses në detyrën që i ishte ngarkuar.

9.2 Pretendimi për cenimin e *parimit të mosdiskriminimit* nuk qëndron, pasi kërkuueses i janë sqaruar arsyet e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, megjithëse ajo ka pretenduar se kjo bëhej për arsye politike.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuueses

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Gjykata çmon se kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Në analizë të kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, mbështetur në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuësja i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshtëm, duke pretenduar cenimin e procesit të rregullt ligjor, si dhe faktin se shkaqet e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës lidheshin me orientimin fetar dhe politik.

13. Për sa i takon pretendimit se zgjidhja e marrëdhënieve të punës ka qenë për shkak të bindjeve fetare, Gjykata vëren se në dosjen gjyqësore, me kërkesë të punëdhënësit, Postës Shqiptare, është administruar si provë praktika e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ky i fundit ka kryer, *ex officio*, shqyrtimin e çështjes dhe në përfundim, me vendimin nr. 80, datë 29.5.2014, ka vlerësuar se

kërkuesja nuk është diskriminuar për shkak të bindjeve fetare nga ana e drejtuesit të Postës Shqiptare. Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se pretendimi për diskriminim në marrëdhëniet e punës për shkak të bindjeve fetare nuk rezulton të jetë parashtruar prej kërkueses gjatë procesit administrativ dhe në asnjë shkallë të procesit gjyqësor, por është artikuluar për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive që ka pasur në dispozicion, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

14. Kërkuesja ka pretenduar, gjithashtu, se është diskriminuar në marrëdhëniet e punës për shkak të bindjeve politike dhe përkatësinë shoqërore në kategorinë e të persekutuarve politikë. Gjykata vëren se ky shkak diskriminimi është deklaruar gjatë procesit administrativ (procesverbalet e mbledhjeve të datave 6.11.2013 dhe 13.3.2014 të përpiluara nga punëdhënësi). Po kështu, ajo ka kundërshtuar në gjykatë zgjidhjen e kontratës së punës për shkaqe të pajustificuara, të cilat nuk i ka specifikuar në aktin e padisë, por gjatë gjykimit ajo ka përmendur, si të tilla, edhe ato me natyrë diskriminuese të lidhura me bindjet politike dhe përkatësinë shoqërore të saj (procesverbali audio i seancës gjyqësore i datës 7.11.2014). Ndërkohë, ky pretendim rezulton se është prapësuar në gjykimin në shkallë të parë edhe nga subjekti i interesuar (prapësimet me shkrim të datës 12.6.2014), si dhe është pasqyruar në vendimin përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë. Në vijim, kërkuesja ka paraqitur apel dhe rekurs, akte në të cilat ka kundërshtuar zgjidhjen e kontratës sërish për shkaqe të pajustificuara, të cilat, referuar akteve në gjykim, përfshinin edhe ato për diskriminim. Në këtë situatë dhe duke mbajtur në konsideratë se argumenti kryesor i kërkueses për kundërshtimin e zgjidhjes së kontratës së punës lidhet me shkaqet e pajustificuara, ku përfshihej edhe ai i diskriminimit për shkak të bindjeve politike, Gjykata çmon se kërkuesja ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion për këtë pretendim.

15. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e parimit të kontradiktoritetit, së drejtës për t'u mbrojtur dhe dëgjuar, parimit të sigurisë juridike dhe ligjshmërisë, Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk ka më mjete të tjera ankimi në dispozicion për mbrojtjen e tyre përveç ankimit kushtetues individual.

16. Për sa i takon legjitimitetit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata ka pranuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesja ka kundërshtuar procesin gjyqësor që është përmbyllur me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 7.12.2022. Me shkresën nr. 3955/1 prot., datë 18.7.2023, Gjykata e Lartë ka informuar se vendimi është publikuar në faqen zyrtare të saj më datë 6.2.2023, ndërsa ankimin kushtetues individual kërkuesja e ka paraqitur nëpërmjet shërbimit postar më datë 27.6.2023, pra pas 4 muajve e 21 ditëve nga publikimi i vendimit.

18. Kërkuesja fillimisht ka pretenduar se vendimi objekt i ankimit kushtetues i është komunikuar më datë 25.4.2023 nga kryesekretaria e gjykatës së Fierit, pasi nga Gjykata e Lartë nuk i ka ardhur asnjë njoftim, duke mos argumentuar përmbushjen e standardeve kushtetuese për momentin e konstatimit të cenimit. Në këto rrethana, Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e ndërmjetëm të datës 11.10.2023, ka vendosur kthimin e akteve kërkueses për plotësim me qëllim paraqitjen e argumenteve dhe provave lidhur me respektimin e afatit ligjor 4-mujor të paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

19. Me paraqitjen e akteve shpesh, rezulton se kërkuesja më datë 27.4.2023, kur ishte ende brenda afatit ligjor 4-mujor, ka kërkuar ndihmë juridike dytësore, falas, për shkak të situatës së saj ekonomike, me qëllim përgatitjen e ankimit kushtetues individual, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier me vendimin e datës 18.5.2023. Në këto rrethana,

duke mos llogaritur kohën gjatë së cilës gjykata e zakonshme ka shqyrtuar dhe miratuar kërkesën për ndihmë juridike falas, Gjykata vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, për rrjedhojë kërkesja legjitimohet *ratione temporis*.

20. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimeve të kontradiktoritetit, së drejtës për t'u mbrojtur dhe dëgjuar, sigurisë juridike dhe ligjshmërisë, si dhe parimin e mosdiskriminimit, të garantuara nga nenet 18 dhe 42 të Kushtetutës.

21. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike, kërkesja ka parashtruar se Gjykata e Lartë duhej të bënte njësimin/ndryshimin e praktikës gjyqësore, sepse në dy raste të tjera ka dhënë vendime që binin ndesh me vendimin e dhënë për të. Në këtë pikë, Gjykata vë në dukje se ndonëse çështja e kërkeses ka ngjashmëri me dy çështje të tjera të shqyrtuara nga Gjykata e Lartë, sepse kanë për objekt zgjidhjen e padrejtë të marrëdhënieve të punës, bazuar në dispozitat e Kodit të Punës, secila prej tyre ka specifikat dhe individualitetin e saj në drejtim të llojit të detyrës dhe shkeljes që ka shërbyer për zgjidhjen e kontratës së punës. Kjo nënkupton se mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit për secilën prej tyre vlerësohet nga gjykata e zakonshme në kontekstin e fakteve dhe provave të çështjes konkrete, të cilat nuk mund të jenë të njëjta. Nën këtë analizë, Gjykata vlerëson se ky pretendim nuk është ngritur në nivel kushtetues dhe, si i tillë, nuk mund të merret në shqyrtim.

22. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e parimeve të kontradiktoritetit, së drejtës për t'u mbrojtur dhe dëgjuar, si dhe ligjshmërisë, kërkesja ka parashtruar disa argumente, të cilat bazohen në faktin se Gjykata e Lartë nuk ka analizuar nëse ekzistojnë ose ajo shkaqet e justifikuara për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Duke pasur parasysh thelbin e argumenteve, Gjykata vlerëson t'i analizojë ato në këndvështrim të standardit të arsytimit të vendimit, duke vënë në dukje se e drejta për proces të rregullt ligjor, në aspektin e arsytimit të vendimit, garantohet nga neni 42 i Kushtetutës.

23. Ndërsa lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të mosdiskriminimit për shkak të bindjeve politike, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës dhe neni 14 i KEDNJ-së, Gjykata, rithekson se ai nuk mund të qëndrojë më vete, por duhet të jetë i lidhur ngushtësisht me ndonjë të drejtë tjetër themelore të parashikuar në Kushtetutë (*shih vendimin nr. 33, datë 12.9.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Nën këtë optikë, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë, nga njëra anë, faktin se për këtë pretendim gjykatat nuk janë shprehur në vendimarrjen e tyre dhe, nga ana tjetër, se argumentet e kërkeses, në thelb, kanë të bëjnë me të drejtën kushtetuese për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme, ajo do ta analizojë çështjen në këndvështrim të standardit të arsytimit të vendimit të lidhur me parimin e mosdiskriminimit dhe me të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme, sipas neneve 18, 42 dhe 49 të Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit të lidhur me parimin e mosdiskriminimit dhe të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme

24. Kërkesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka analizuar nëse kanë ekzistuar ose jo shkaqet e justifikuara për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Sipas saj, shkaqet e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës lidhen me arsye politike, duke qenë se ajo është e persekutuar politike dhe e orientuar me ide politike të djathta. Për këtë qëllim ajo ka paraqitur vërtetimin nr. E-238/1 prot., datë 20.11.2018 të Ministrisë së Brendshme, me të cilin i është njohur koha e dëbimit nga Tirana në Fier në periudhën 12.2.1966–29.6.1990, për çështje politike.

25. Subjekti i interesuar, Posta Shqiptare, ka prapësuar në mënyrë të vazhdueshme se kërkesja nuk ka realizuar punën e ngarkuar dhe për këtë shkak ndaj saj është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” dhe është penalizuar me mbajtjen e 10% të pagës mujore. Sipas tij, kërkesja nuk paraqitej në punë dhe nga qytetarët kishte ankesa për shpërndarjen e faturave, prandaj

nisën procedurat për dhënien e masës disiplinore të largimit nga puna, të cilat u finalizuan me vendimin e datës 13.3.2014.

26. Në nenin 42 pika 2, të Kushtetutës parashikohet, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Kurse, neni 49, po aty, garanton që secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë (*pika 1*). Nga ana tjetër, Kushtetuta në nenin 18 të saj parashikon parimin themelor të barazisë përpara ligjit, sipas të cilit, askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht, ndër të tjera, mbi baza të bindjeve politike ose gjendjes sociale (*pika 2*) dhe se askush nuk mund të diskriminohet për këto shkaqe, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.

27. Gjykata ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Lidhur me vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, Gjykata ka vënë në dukje se, si rregull, arsyetimi i kufizuar i tyre nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 9, datë 26.3.2018; nr. 8, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*), por kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 45, datë 3.7.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Për sa i takon nenin 49, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata është shprehur se kjo e drejtë kushtetuese përfshin, ndër të tjera, zgjedhjen e profesionit dhe vendit të punës, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. E drejta për të përfituar me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi (*shih vendimet nr. 1, datë 25.1.2024; nr. 17, datë 23.3.2023; nr. 9, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Ndërsa lidhur me parimin e mosdiskriminimit, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se ai synon që të gjithë të jenë të barabartë në/përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta, dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (*shih vendimet nr. 31, datë 4.10.2021; nr. 27, datë 29.6.2021; nr. 10, datë 29.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Po kështu, Gjykata vë në dukje se Shqipëria është shtet anëtar me të drejta dhe detyrime të plota i Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” (*Konventa e CEDAW*), e cila ka sanksionuar detyrimin e shteteve palë për të marrë të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas në çështje të tilla që lidhen me të drejtën për punë si një e drejtë e pamohueshme, të drejtën për të zgjedhur lirisht profesionin dhe vendin e punës, të drejtën për punë të qëndrueshme, për të gjitha përfitimet dhe kushtet e punës, si dhe një sërë të drejtash të tjera që rrjedhin nga punësimi (*neni 11*).

31. Mbrojtja nga diskriminimi gjendet i parashikuar specifikisht edhe në nenin 14 të KEDNJ-së, i cili ndalon shprehimisht kufizimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të garantuara nga kjo Konventë për shkaqe të ndryshme, ku përfshihen edhe pikëpamjet politike dhe prejardhja sociale. Kjo mbrojtje përforcohet edhe nga neni 1 i Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, i cili ndalon në çdo rast diskriminimin edhe në gëzimin e të drejtave të parashikuara nga ligji.

32. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka theksuar se neni 14 i KEDNJ-së gjen zbatim edhe kur shtetet, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, nuk i trajtojnë ndryshe personat situatat e të cilëve janë thelbësisht të ndryshme (*shih Eweida dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 15.1.2013, § 87*). Sipas saj, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim, diskriminimi i

drejtpërdrejtë konsiderohet si “*dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme*” dhe “*bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm*” (shih Biao kundër Danimarkës [DbM], datë 24.5.2016, § 89).

33. Nga ana tjetër, kuadri ligjor ofron disa garanci për mbrojtjen nga diskriminimi në marrëdhëniet e punës. Kështu, neni 9 i Kodit të Punës parashikon ndalimin e çdo forme diskriminimi në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion (*pika 1*). Me “*diskriminim*”, sipas këtij kodi, kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet, ndër të tjera, në bindjet politike dhe gjendjen shoqërore ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët (*pika 2*). Në të njëjtën linjë, ligji nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar (*ligji nr. 10221/2010*), ka rregulluar në mënyrë të posaçme parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, të lidhur, ndër të tjera, me shkakun e bindjeve politike dhe gjendjen shoqërore (*neni 1*). Sipas ligjit, me “*diskriminim*” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përcaktuar në të, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta, aktet ndërkombëtare të ratifikuara, si dhe nga ligjet në fuqi (*neni 3, pika 1, i ligjit nr. 10221/2010*).

34. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se kërkuesja ka qenë në marrëdhënie pune pranë Postës Shqiptare, me detyrë shpërndarëse e postës për 6 vjet. Më datë 13.3.2014, asaj i është dhënë masa disiplinore e largimit nga detyra, me arsyetimin se kishte pasur mangësi në punë. Kërkuesja ka ngritur padi në gjykatë, duke pretenduar se zgjidhja e marrëdhënieve të punës ishte rrjedhojë e shkaqeve të pajustificuara, që lidheshin me arsyet politike dhe statusin shoqëror të saj. Më konkretisht, ajo ka përdorur termit “*bindje politike / luftë e klasave / e persekutuar*” (shih procesverbalet nr. 53, datë 6.11.2013, nr. 22, datë 13.3.2014, nr. 227/2 prot., datë 13.3.2014 të mbledhjeve të punëdhënësit; procesverbalin gjyqësor të seancës së 7.11.2014 dhe regjistrimi audio minuta 11:18; prapësimet e punëdhënësit të datës 12.6.2014 të paraqitura në gjykimin në shkallë të parë). Këtij pretendimi, punëdhënësi i është përgjigjur se barra e provës, për të vërtetuar diskriminimin për shkaqe politike, i takon kërkueses, sipas nenit 146 të Kodit të Punës (shih fagen 4 të prapësimeve të datës 12.6.2014), duke mbajtur qëndrimin se shkaqet e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës lidheshin me mangësitë në punë dhe, për rrjedhojë, ishin të justifikuara.

35. Po kështu, Gjykata vë në dukje se as gjykata e shkallës së parë, as ajo e apelit nuk e kanë shqyrtuar në themel pretendimin e kërkueses për diskriminim, por duket se kanë mbajtur qëndrim formalist në shqyrtimin e akteve. Ndonëse ato e kanë pasqyruar në tekstin e vendimeve pretendimin për diskriminim për arsye politike dhe prapësimet e punëdhënësit, në arsyetimin e vendimeve janë mjaftuar me konkluzionin e paraqitur nga punëdhënësi se kërkuesja ka vepruar me faj të rëndë, duke mos zbatuar detyrimet e saj kontraktore, sipas parashikimeve të Kodit të Punës, gjë e cila ka sjellë zgjidhjen e menjëhershme dhe për shkaqe të justifikuara të kontratës së punës. Ndërsa, Gjykata e Lartë, me arsyetim të kufizuar, ka vlerësuar se në gjykimin e çështjes së kërkueses nuk rezultonte të ishin lejuar shkelje procedurale që do ta bënin të pavlefshëm procesin dhe do të ndikonin në vendimmarrjen e gjykatave. Sipas saj, gjykatat më të ulëta e kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejtë atë, dhe se vendimet e dhëna prej tyre nuk janë në kundërshtim me ndonjë vendim të vetë asaj gjykate.

36. Gjykata vëren se kërkuesja ka parashtruar disa fakte me rëndësi në drejtim të diskriminimit në punë. Kështu, ajo i përket një kategorie të veçantë shoqërore – të përndjekurve politikë gjatë regjimit komunist. Ajo kishte filluar marrëdhëniet e punës në një shoqëri aksionere me kapital shtetëror (Posta Shqiptare sh.a.) në vitin 2008. Pas zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të vitit 2013, të cilat rezultuan me rotacion politik në qeverisjen qendrore dhe ndryshime të drejtuesve të institucioneve shtetërore, kërkueses iu dhanë në vijimësi 3 masa disiplinore – vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra (8.11.2013), penalizim me mbajtjen e 10% të pagës mujore (10.2.2014) deri në largimin nga detyra (13.3.2014). Vetë kërkuesja ka parashtruar se, për shkak të statusit shoqëror, ka bindje politike

të kundërta me shumicën qeverisëse, që, sipas saj, ishin shkaku i vërtetë i zgjidhjes së marrëdhënieve të punës.

37. Në këtë kontekst, Gjykata, bazuar në nenet 18 dhe 49 të Kushtetutës, vlerëson se bindjet politike dhe gjendja sociale janë rrethana, të cilat përbëjnë shkak për dallim, përjashtim ose kufizim që sjell si pasojë pengesën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme. Nën këtë këndvështrim, duke mbajtur në konsideratë se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk janë shprehur për këtë pretendim me natyrë kushtetuese të kërkuësës, si dhe qëndrimin e punëdhënësit se barra e provës për të vërtetuar diskriminimin i përkiste asaj, Gjykata çmon se duhet analizuar në rrafshin kushtetues se kujt prej palëve që janë të përfshira në marrëdhëniet e punës (punëdhënës dhe/ose punëmarrës) i takon barra e provës.

38. GJEDNJ-ja, gjatë shqyrtimit të çështjeve ku është ngritur pretendimi për diskriminim, ka përcaktuar se, pasi kërkuesi ka treguar një ndryshim në trajtim, i takon shtetit përgjegjës të tregojë se trajtimi i ndryshëm ishte i justifikuar (*shih Timishev kundër Rusisë, datë 13.12.2005, § 57*). Kur Gjykata, bazuar në rrethanat konkrete, pranon që ka një çështje *prima facie* diskriminimi, atëherë barra e provës kalon te shteti përgjegjës për të siguruar justifikimin e tij. Rrethanat specifike të fakteve dhe natyra e pretendimeve në disa raste e bëjnë jashtëzakonisht të vështirë në praktikë për kërkuësin të provojë diskriminimin, ndaj bëhet i nevojshëm kalimi i barrës së provës tek autoritetet përgjegjëse (*shih Cînta kundër Rumanisë, datë 18.2.2020, §79*).

39. Në mendimin me shkrim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është shprehur se vetëm fakti se punëmarrësi provon se mbart një shkak diskriminimi të mbrojtur me ligj, nuk mjafton për të provuar motivin diskriminues për largimin nga puna. Të provuarit e diskriminimit është i vështirë, ndaj në këto çështje zbatohet parimi i ndarjes së barrës së provës. Autori i diskriminimit shpesh ka kontroll për informacionin e nevojshëm për të provuar diskriminimin dhe për më tepër që kush diskriminon nuk do të pranonte kurrë qëllimin për të diskriminuar. Sipas Komisionerit, gjykata në shqyrtimin e çështjeve të diskriminimit duhet të bëjë ndarjen e barrës së provës, ku paditësi mund të tregojë disa fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka ndodhur diskriminimi dhe barra e provës bie mbi të paditurin që të provojë të kundërtën. Në këtë rast, i padituri duhet të vërtetojë se arsyeja pas trajtimit nuk ka asnjë lidhje me shkakun e mbrojtur/shkakun diskriminues dhe nëse shpjegimi i tij nuk është i përshtatshëm, atëherë gjykata duhet ta shpallë diskriminimin të vërtetuar.

40. Për sa më lart, Gjykata thekson se neni 18 i Kushtetutës, që parashikon ndalimin e diskriminimit, para së gjithash, sanksionon një detyrim negativ, sipas të cilit askush të mos diskriminohet padrejtësisht për shkaqe që lidhen, ndër të tjera, me bindjet politike ose me gjendjen shoqërore. Në këtë pikë, Gjykata evidenton se aty ku ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, i takon autorit të diskriminimit, në këtë rast punëdhënësit, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të këtij parimi. Kalimi i barrës së provës nga punëmarrësi (*viktima e diskriminimit*) te punëdhënësi (*autori i diskriminimit*) lidhet me vulnerabilitetin e të diskriminuarit, ndaj ai mjafton të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë *prima facie* ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij. Nga ana tjetër, gjykata ka detyrën për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura nga punëdhënësi janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se zgjidhja e marrëdhënieve të punës nuk ka qenë për shkaqe diskriminuese. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se barra e provës në lidhje me shkaqet për diskriminim në marrëdhëniet e punës i përket fillimisht punëmarrësit, por nëse ky i fundit paraqet disa fakte, të cilat mbështesin në mënyrë të arsyeshme një prezumim për diskriminim, barra e provës kalon te punëdhënësi.

41. Duke iu rikthyer edhe njëherë çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se në kushtet kur “*bindjet politike*” dhe “*gjendja shoqërore*” përbëjnë shkaqe kushtetuese për diskriminim të padrejtë në marrëdhëniet e punës, gjykatat kishin detyrimin të verifikonin pretendimin e kërkuësës dhe t’i jepnin

përgjigje të arsyetuar, pasi ai ka qenë vazhdimisht i shprehur prej saj dhe vetë pala paditëse e ka konfirmuar këtë në prapësimet e saj përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, por edhe në prapësimet e paraqitura në gjykimin kushtetues të çështjes. Në këtë proces verifikimi, gjykatat duhej të analizonin në mënyrë të shprehur nëse faktet e paraqitura nga kërkuësja shërbenin në mënyrë të mjaftueshme që barra e provës për diskriminim të kalonte te punëdhënësi, Posta Shqiptare dhe, eventualisht, ky i fundit, të vërtetonte se nuk kishte ndonjë lidhje shkakësore midis gjendjes shoqërore dhe bindjeve politike të kërkuësës dhe trajtimit të pafavorshëm të pretenduar prej saj. Ndërkohë, edhe Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur një qëndrim të shprehur në lidhje me të, pavarësisht se shkak i pretenduar ka natyrë kushtetuese.

42. Për sa më sipër, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuësës, në thelb, ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit të lidhur me parimin e mosdiskriminimit dhe të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme. Në vlerësimin e Gjykatës, është detyrë e Gjykatës së Lartë që për shkak të natyrës subsidiare që ka gjykimi kushtetues, të arsyetojë, qoftë në mënyrë të kufizuar, vendimin e saj, në rastet kur pretendimet e ngritura në rekurs kanë të bëjnë me cenimin e parimeve kushtetuese, të cilat gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, pra për ato pretendime kushtetuese që nuk duken se janë haptazi të pabazuara.

43. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuësës janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-3578, datë 7.12.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
 3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 12.3.2024.

Shpallur, më 11.4.2024.

Kryetare (kundër): Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini

Anëtar kundër: Elsa Toska, Ilir Toska, Genti Ibrahim

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 14 (E) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket kërkuësës Elisabeta Cara, me objekt: “*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-3578, datë 7.12.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, jemi kundër qëndrimit të shumicës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte rrëzuar për shkak se kërkuësja nuk legjitimohej për vënien në lëvizje të Gjykatës, në kushtet kur ajo nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion përpara

se t'i drejtohej asaj për pretendimin e cenimit të parimit të mosdiskriminimit për shkaqe të bindjeve politike dhe gjendjes shoqërore. Për këtë arsye, çmojmë të shprehemi me mendim pakice.

2. Sipas nenit 131, shkronja "P", të Kushtetutës parashikohet se "*Gjykata Kushtetuese vendos për: f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë*". Ky parashikim gjendet i materializuar edhe në përmbajtjen e nenit 71/a, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000, i cili përcakton se: "*Ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese kur: a) kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese ose kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete juridike efektive në dispozicion*".

3. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se, sipas neneve 131, shkronja "P" dhe 134, pika 1, shkronja "I", të Kushtetutës, individ mund t'i drejtohet asaj me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë. Kjo nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 31, datë 4.10.2021; nr. 38, datë 25.4.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se, në thelb, rregulli për shterimin e mjeteve juridike përpara se t'i drejtohen Gjykatës me ankim kushtetues synon t'u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime tek organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 10, datë 7.3.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se objekti dhe shkaqet e kërkesës, me të cilat ngrihet çështja e kushtetutshmërisë, përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimit kushtetues (*shih vendimin nr. 22, datë 11.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Në vlerësimin tonë, çështja në shqyrtim duhej të ishte analizuar bazuar në standardet e mësipërme, mbështetur në të cilët arrijmë në konkluzionin se kërkesa e kërkueses duhej të rrëzohej.

5. Konkretisht, referuar rrethanave të çështjes, në mënyrë të përmbledhur, ka rezultuar se kërkuësja ka ushtruar detyrën e shpërndarëses pranë Postës Shqiptare sh.a., Filiali Fier deri më datë 13.3.2014, kur ndaj saj është dhënë masa disiplinore e largimit nga detyra për shkak të konstatimit të mangësive në punë, bazuar në Kodin e Punës dhe kontratën kolektive të punës.

6. Ndërprerjen e marrëdhënieve të punës kërkuësja e ka kundërshtuar në gjykatë me padi me objekt detyrimin e punëdhënësit për dëmshpërblimin me 17 paga mujore, për: (i) mosrespektimin e afateve të njoftimit; (ii) mosrespektimin e procedurave të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës; (iii) zgjidhjen e menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara të marrëdhënieve të punës; si dhe (iv) detyrimin për shpërblim për vjetërsi në punë, sipas përcaktimeve të neneve 143, 144, 145, 155, pikat 1 dhe 3, të Kodit të Punës. Si shkak ligjor të padisë kërkuësja ka përcaktuar zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, duke pretenduar se ka përmbushur detyrimet kontraktuale dhe se shpeshherë është vlerësuar nga eprorët si shembull për të tjerët.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e datës 14.1.2015 ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se kontrata ishte zgjidhur në mënyrë të menjëhershme dhe për shkaqe të justifikuara në

përputhje me përcaktimet e Kodit të Punës. Sipas gjykatës, kërkuesja ka vepruar me faj të rëndë, duke mos zbatuar detyrimet e saj kontraktuale, pasi, në cilësinë e punëmarrëses, nuk ka ofruar shërbimin për punëdhënësin, madje i ka krijuar atij vështirësi të dukshme në procesin e shërbimit postar të destinatarit, veprimtari për të cilën ai duhet të jetë konkurrent në treg si shoqëri publike. Po sipas gjykatës, ishte pikërisht sjellja jo korrekte e paditëses në punë, që me faj të rëndë në formën e neglizhencës, ka çuar punëdhënësin në zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës dhe se qëndrimi i tij gjendet i bazuar në parashikimet e neneve 153 dhe 154 të Kodit të Punës, si dhe të nenit 18, shkronja "b", të marrëveshjes kolektive të punës të datës 15.3.2011.

8. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka ushtruar ankim, në përmbajtje të të cilit ka parashtuar, në mënyrë të përmbledhur, se gjykata e shkallës së parë ka bërë interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit material dhe se vendimi është në kundërshtim me provat e administruara. Sipas kërkueses, gjykata i ka marrë të mirëqena prapësimet e punëdhënësit pa bërë një hetim gjyqësor të gjithanshëm. Masat disiplinore të dhëna nga punëdhënësi gjatë vazhdimit të marrëdhënieve të punës nuk i janë komunikuar asnjëherë dhe se punëdhënësi nuk ka paraqitur prova për të bindur gjykatën se sa ishte në përqindje ngarkesa e punës që ajo duhej të përballonte dhe në çfarë mase nuk është realizuar. Po sipas kërkueses, ngarkimi i një detyre jashtë kapacitetit njerëzor përbën diskriminim të punëmarrësit dhe vënien në pozita inferiore, duke shfrytëzuar nevojën e tij për punë. Largimi nga puna për mospërmbushje të një detyre kur ajo është objektivisht e pamundur të përmbushet brenda një afati të caktuar, nënkupton keqbesimin e punëdhënësit në marrëdhënien e punës.

9. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin e datës 14.7.2015 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke ndjekur të njëjtën linjë arsyetimi me të. Sipas gjykatës së apelit, nga tërësia e akteve të administruar në gjykim, rrethanat e faktit, si dhe nga analiza në vazhdimësi e veprimeve të kërkueses, është provuar se ajo nuk ka zbatuar detyrat në zonën që ka kryer shërbimin e shpërndarës së postës. Veprimet jo të ligjshme të kërkueses bëjnë që masa disiplinore e largimit nga detyra të jetë e bazuar dhe, për rrjedhojë, vendimi i gjykatës së shkallës së parë të jetë i bazuar në ligj dhe në prova.

10. Në rekursin e ushtruar në Gjykatën e Lartë, kërkuesja ka parashtuar se: (i) dy gjykatat më të ulëta kanë zbatuar keq ligjin; (ii) nuk kanë respektuar kërkesat e nenit 153 të Kodit të Punës për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së paditëses për shkaqe të justifikuara, pasi e kanë vlerësuar vendimin për thyerjen e disiplinës së rëndë për shkak të rëndësisë së veçantë që kishte pjesëmarrja e saj në shpërndarjen e postës; (iii) nuk kanë hetuar nëse ekzistojnë shkaqet e justifikuara të zgjidhjes së kontratës së punës; (iv) nuk kanë arsyetuar se cilën pikë të rregullores së punës ka shkelur ose ka përmendur se ka pasur ankesa, por nuk ka evidentuar asnjë rast që persona fizikë e juridikë të jenë ankuar që korrespondenca e tyre të mos ketë shkuar në destinacion; (v) çdo objekt postar ajo e ka pasqyruar në librin përkatës të postës dhe punëdhënësi nuk ka provuar që ajo nuk ka çuar në destinacion objektin postar, pra nuk është provuar që ajo të ketë humbur, zhdukur ose të ketë dorëzuar me vonesë një objekt postar të rëndësisë së veçantë; (vi) ankimi i saj lidhur me ngarkesën në punë në shpërndarjen e faturave nuk ka përse të konsiderohet dhe të interpretohet sikur ajo ka shkelur disiplinën në punë, por ka qenë ankesë për ndihmë që këto fatura të bëheshin sa më shpejt, pasi në këtë periudhë ato kanë qenë masive, për shkak të masave që mori qeveria në likuidimin e faturave të energjisë elektrike.

11. Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 7.12.2022 ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Sipas saj, gjykatat më të ulëta kanë respektuar ligjin material duke e interpretuar dhe zbatuar drejtë atë dhe se vendimet e tyre nuk janë në kundërshtim me ndonjë vendim të Gjykatës së Lartë, ndërsa pjesa e pretendimeve që ngre çështje të vlerësimit të provave, del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të saj.

12. Ky vendim është kundërshtuar nga kërkuesja me ankim kushtetues individual, e cila, ndër të tjera, ka pretenduar se shkaqet e vërteta për zgjidhjen e kontratës së punës kanë qenë ato me natyrë diskriminuese, pasi ajo është praktikante e fesë myslimane, e persekutuar politike dhe e orientuar me ide politike të djathta. Ky fakt, sipas kërkueses, vërtetohet me shkresën e datës 20.11.2018, të Ministrisë së Brendshme, përmes së cilës asaj i është njohur koha e dëbimit nga Tirana në Fier, nga data 12.2.1966 deri më datë 29.6.1990, për çështje politike.

13. Në vijim të shqyrtimit të ankimit kushtetues, shumica ka vlerësuar se kërkuesja ka kundërshtuar në gjykatë zgjidhjen e kontratës së punës për shkaqe të pajustificuara, të cilat nuk i ka specifikuar në aktin e padisë, por gjatë gjykimit, ajo ka përmendur, si të tilla, edhe ato me natyrë diskriminuese të lidhura me bindjet politike dhe përkatësinë shoqërore të saj; ky pretendim është prapësuar në gjykim në shkallë të parë edhe nga subjekti i interesuar dhe është pasqyruar në vendimin përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë; në apel dhe rekurs kërkuesja ka kundërshtuar zgjidhjen e kontratës sërisht për shkaqe të pajustificuara, të cilat, referuar akteve në gjykim, përfshinin edhe ato për diskriminim. Në këtë situatë, shumica, ka çmuar se kërkuesja ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion për këtë pretendim (*shih paragrafin 14 të vendimit*). Në vijim, shumica e ka analizuar çështjen në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me parimin e mosdiskriminimit dhe me të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme, sipas neneve 18, 42 dhe 49 të Kushtetutës (*shih paragrafin 23 të vendimit*). Në përfundim, shumica ka arsyetuar se gjykatat kishin detyrimin të verifikonin pretendimin e kërkueses dhe t'i jepnin përgjigje të arsyetuar, ndërkohë që edhe Gjykata e Lartë, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkueses, në thelb, ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit të lidhur me parimin e mosdiskriminimit dhe të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme (*shih paragrafët 41 dhe 42 të vendimit*).

14. Përkundër vlerësimit të shumicës, sikurse rezulton edhe nga pasqyrimi i detajuar i përmbajtjes së padisë, ankimit dhe rekursit (*shih paragrafët 6, 8 dhe 10 më sipër*), kërkuesja nuk ka pretenduar në aktet me shkrim drejtuar të tria gjykatave të juridiksionit të zakonshëm se shkak për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës ka qenë diskriminimi për arsye të përkatësisë politike dhe shoqërore. Ndonëse në procesverbalet e mbajtura nga punëdhënësi dhe në procesin përpara gjykatës së shkallës së parë kërkuesja e ka përmendur faktin se procesi administrativ ndaj saj është bërë për arsye politike, konstatohet se ajo nuk e ka kërkuar ose argumentuar atë as gjatë gjykimit në shkallë të parë, as gjatë gjykimit në apel, dhe as gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë (*shih paragrafët 7, 9 dhe 11 më sipër*). Shkaqet e paraqitura nga kërkuesja në të tria aktet, nëpërmjet të cilave ajo ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, lidheshin me faktin se punëdhënësi ka zgjidhur kontratën e punës në mënyrë të menjëhershme, të pajustificuar, ndërsa ajo ka kryer detyrat e ngarkuara me korrektësi. Për më tepër, në asnjë prej akteve të paraqitura (padi, ankim, rekurs), kërkuesja nuk ka referuar, qoftë edhe formalisht, nenin 146 të Kodit të Punës, i cili rregullon zgjidhjen e kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme ose për shkaqe abuzive, ku, si i tillë, përcaktohet edhe kur punëdhënësi shkel ndalimin e diskriminimit, sipas përcaktimeve në këtë kod dhe në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi (*pika 1, shërkronja "c"*), gjë e cila e bën zgjidhjen e kontratës së punës të pavlefshme (*pika 3, po aty*). Ndërkohë që çështja e largimit nga puna për shkaqe diskriminuese, sikurse ato me natyrë fetare dhe politike, janë artikuluar dhe pasqyruar me shkrim dhe qartazi, për herë të parë, vetëm në ankimin kushtetues të paraqitur përpara Gjykatës.

15. Bazuar në faktet e mësipërme që marrin vlerë në një gjykim kushtetues, vlerësojmë se lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të mosdiskriminimit, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive që ka pasur në dispozicion, për rrjedhojë ajo nuk e ka përmbushur këtë kriter të legjitimitetit për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues.

16. Në kushtet kur përmbushja e kriterëve të legjitimitetit është kumulative, shqyrtimi i bazueshmërisë së këtij pretendimi në themel nuk duhej të kishte vijuar. Shumica e ka vlerësuar atë të

lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, megjithëse Gjykata e Lartë duket që u ka dhënë përgjigje shkaqeve të parashtruara në rekursin e kërkuases. Për më tepër, evidentojmë se, sikundër u theksua më lart, kërkuësja nuk i ka orientuar gjykatat e zakonshme drejt faktit se shkaqet për largimin e saj nga puna lidheshin me arsye diskriminuuese, prandaj shqyrtimi i pretendimeve të kësaj natyre nga Gjykata nuk do të ishte në përputhje me parimin e subsidiaritetit. Lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, Gjykata ka theksuar se kur është rasti i shqyrtimit nga ana e saj i kërkesave individuale, në bazë të nenit 131, shkronja “P”, të Kushtetutës, ajo udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit, pasi një qëndrim i ndryshëm do ta kthente atë në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Ne, gjyqtarët në pakicë, në nivel parimor të ndarjes së juridiksioneve dhe në respektim të parimit të subsidiaritetit, vlerësojmë se juridiksioni kushtetues nuk duhet t'i mbivendoset atij gjyqësor, i cili, në rastin konkret, në përmbushje të detyrës funksionale ka analizuar provat dhe faktet, si dhe ka zgjidhur çështjen e themelit, mbështetur në pretendimet dhe kërkimet e vetë kërkuases, brenda kuadrit kushtetues dhe ligjor.

18. Për sa më lart, në kuptim të normave kushtetuese, standardeve jurisprudenciale të kësaj Gjykate dhe rrethanave të rastit konkret, çmojmë se vlerësimi i Gjykatës në lidhje me pretendimin e kërkuases për cenimin e parimit të mosdiskriminimit për shkaqe të bindjeve politike dhe gjendjes shoqërore, duhej të ishte ndalur në çështjen e legjitimitetit të saj, pa vijuar më tej me bazueshmërinë në themel të këtij pretendimi, ndaj edhe për këtë shkak kërkesa duhej të rrëzohej.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Ilir Toska, Genti Ibrahim, Elsa Toska